

Volumi Nr.4

ISSN 2521-831X

Nr.48

Dhjetor 2020

BULETINI MUJOR

KLIMATIK

U P T

IGJEUM

Departamenti

i Klimës dhe

Mjedisit

Tiranë © 2020





Pamje gjatë natës e kontinentit European ku evidentohet ndriçimi në zonat urbane. Më datë 21 dhjetor 2020 shënohet solstici dimëror dhe nata më e gjatë. Në gjerësitë gjeografike ku ndodhet vendi ynë ajo arrin mbi 14 orë ndërsa, pranë polit të veriut shënon 24 orë. Për Tiranën ● ishte 14 orë, 48 minuta e 40 sekonda.



BULETINI MUJOR KLIMATIK

Nr.48

Dhjetor 2020

Viti i IV i
botimit
IGJEUM - UPT

Përmbledhje. Muaji dhjetor 2020 u karakterizua me temperatura të ajrit më të larta se norma me $+3.1^{\circ}\text{C}$, shmangiet e të cilave në shkallë vendi ishin më të theksuara në pjesën jugore të Shqipërisë. Reshjet nga ana e tyre në muajin dhjetor shënuan një shmangie pozitive me 112.7% të madhësive të normës. Muaji dhjetor, për fushën e bujqësisë shënoi fundin e periudhës së vegetacionit, gjë e cila pasqyrohet dhe në treguesit e NDVI, të cilët japin një informacion më të hollësishëm për fermerët dhe lexuesit e interesuar në këtë fushë. Ky buletin përmban informacion mbi motin e hapësirës dhe situatës sinoptike të muajit dhjetor si dhe mbi potencialin energjistik që ofron rrezatimi diellor i nevojshëm në vlerësimin e energjive të rinovueshme. Gjithashtu, vlerësime mbi klimën urbane, ndryshimet klimatike, motin ekstrem dhe një vlerësim mbi situatën meteorologjike të muajve në vijim është pjesë e analizës shkencore dhe paraqitjes në këtë buletin. Një artikull shkencor: "Assessment of Energy demand for Heating and Cooling, according to degree days based on the UKMO method", përmbyll buletin me disa njohuri shkencore mbi inteligjencën artificiale (IA) në fushën meteorologjike.

Summary. December 2020 was characterized by air temperatures higher than the norm with $+3.1^{\circ}\text{C}$, the deviations of which nationwide were more pronounced in the southern part of Albania. Rainfall in December marked a positive deviation of 112.7% of the rate. The month of December marked the end of the vegetation period for the field of agriculture, which is also reflected in the NDVI indicators, that provide more detailed information for farmers and readers interested in this field. This bulletin contains information on the space weather and synoptic situation of December as well as on the energy potential offered by the solar radiation needed in the evaluation of renewable energies. Also, assessments on urban climate, climate change, extreme weather and an evaluation on the meteorological situation for the coming months is part of the scientific analysis and presentation in this bulletin. A scientific article: "Assessment of Energy demand for Heating and Cooling, according to degree days based on the UKMO method", concludes the bulletin with some scientific knowledge on artificial intelligence (AI) in the field of meteorology.



Tabela Nr.1. - Numri ditëve pa njolla diellore sipas viteve.


Ditë pa njolla diellore

2020 total: 208 ditë (57%)
2019 total: 281 ditë (77%)
2018 total: 221 ditë (61%)
2017 total: 104 ditë (28%)
2016 total: 32 ditë (9%)
2015 total: 0 ditë (0%)
2014 total: 1 ditë (<1%)
2013 total: 0 ditë (0%)
2012 total: 0 ditë (0%)
2011 total: 2 ditë (<1%)
2010 total: 51 ditë (14%)
2009 total: 260 ditë (71%)
2008 total: 268 ditë (73%)
2007 total: 152 ditë (42%)
2006 total: 70 ditë (19%)

Informacion: 31 dhjetor 2020

Situata e motit të hapësirës në fund të muajit dhjetor shënoi 208 ditë pa njolla diellore. Në vijim në figurën Nr.1 paraqitet situata e datës 31 dhjetor 2020.

Figura Nr.1. - Pamje e njollave diellore më datë 31 dhjetor 2020 (SDO/HMI).




Viti 2020 shënoi dhe futjen në ciklin e 25 të njollave diellore. Kjo evidentohet dhe nga të dhënat e paraqitura në tabelën Nr.1, ku periudha midis dy viteve 2019 dhe 2020 shënoi minimumin e njollave diellore dhe pjesa e dytë e vitit 2020 shënoi përfundimisht futjen në ciklin e ri. Gjatë muajit dhjetor 2020 në atmosferë u vrojtua më datë 22 dhjetor 2020 dhe një asteroid me diametër 7 metra që ra me shpejtësi 13.6 km/sek në provincën Qinghai të Kinës, duke shpërthyer në lartësinë 35.5 km nga sipërfaqja e Tokës. Shpërthimi u shoqërua me një energji të lëshuar në atmosferë të barabartë me 9.5 kt. Për krahasim me shpërthimin atomik të Hiroshimës që ishte 16kt, ky shpërthim arriti në vlerën rreth 60% të atij të bombës atomike.

Gjatë muajit dhjetor 2020 observatori heliosferik diellor (SOHO) paraqitur në figurën Nr.2 shënoi 25 vjetorin. Ai u lëshua në vitin 1995 me synimin që të funksiononte për rreth dy vjet, por ai shënoi

rekord në jetëgjatësi dhe gjatë këtyre viteve ka shërbyer dhe zbuluar më shumë se 4000 kometa, ka bërë me dije shkencëtarët në tokë për rreth 30000 shpërthime diellore, ka shënuar zbulimin e parë të një “Cunami diellor”, etj., etj, duke e bërë atë në vetvehte si pasqisjen hapësinorë që renditet në vend të parë duke mbijetuar për dy cikle diellore.

Figura Nr.2. - Sateliti SOHO.



Gjatë muajit dhjetor 2020 diçka e veçantë u evidentua rreth 50 milje mbi Antarktidë. Re të tipit Noktikulent (NLC), të cilat zakonisht zbardhojnë mbi kontinentin e ngrirë në këtë muaj, pothuajse munguan tërësisht gjatë këtij dhjetori 2020. Një paraqitje e kësaj situatë jepet në figurën Nr.3.





Figura Nr.3. - Pamje të reve Noktikulent në dhjetor të vitit 2019 dhe situata me pak të tilla në muajin dhjetor 2020, (NASA).

Nga pikëpamja e motit të hapësirës vitit 2020 mbyllet me një situatë të qetë të Diellit, ku nuk shënohen as stuhi, as shpërthime, as erë diellore,

ndërkohë dhe ato njolla prezente janë në shuarje e sipër. Në vijim në figurën Nr.4 jepet një pamje e aurorave më datë 21 dhjetor 2020.

Figura Nr.4. - Pamje e aurorave me datë 21 dhjetor 2020 në ditën e solsticit dimëror, kur vrojtohet dhe nata më e gjatë në hemisferën veriore, nga Aberdeenshire në Skoci.





SITUATA SINOPTIKE - për muajin dhjetor 2020 pasqyrohet nëpërmjet disa prej hartave të përzgjedhura sinoptike në shkallë kontinentale për datat 1, 11, 21 dhe 31 dhjetor 2020, të cilat janë paraqitur në figurën Nr.5 (*me presion të lartë atmosferik – High dhe të ulët – Low*). Sa i takon situatës sinoptike përgjatë muajit dhjetor, territori i vendit tonë është gjendur në pjesën më të madhe të kohës nën ndikimi qendrave barike të presionit atmosferik të ulët.




Figura Nr.5. - Situatat sinoptike të datave: 1, 11, 21 dhe 31 dhjetor 2020.

Më konkretisht gjatë dekadës së parë të muajit dhjetor vendi ynë ishte nën ndikimin e fronteve atmosferike me qendra barike të presionit të ulët. Kjo është shoqëruar me vranësira dhe reshje shiu kryesisht në pjesën jugore dhe perëndimore të Shqipërisë. Në dhjetëditëshin e dytë të muajit dhjetor situata sinoptike në Shqipëri ishte më e qëndrueshme, ndërsa i treti përsëri me paqëndrueshmëri atmosferike.




Figura Nr.6. – Situata e vranësirave sipas pamjeve satelitore gjatë muajit dhjetor 2020.

Deri në datën 25 dhjetor vendi ynë ishte i ndikuar nga qendrat barike të presionit atmosferik të lartë, duke përcjellë

masa ajrore më të qëndrueshme dhe shoqëruar me një mot të kthjellët dhe me vranësira të pakta. Gjatë javës së fundit të vitit 2020, në territorin e vendit tonë mbizotëruan qendrat barike të presionit atmosferik të ulët me origjinë nga Europa jugore, të cilat janë shoqëruar me vranësira dhe reshje shiu në pjesën më të madhe të vendit.



KARAKTERISTIKAT KRYESORE METEOROLOGJIKE TE MUAJIT DHJETOR 2020 DHE DISA KONSIDERATA MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

Departamenti i Klimës dhe Mjedisit

TEMPERATURAT MESATARE TË AJRIT. - Muaji dhjetor 2020 si në shkallë globale ashtu dhe në kontinentin tonë u karakterizua me vlera temperature mbi normë. Në vijim në figurën Nr.7 jepet një paraqitje e kësaj situatë. Shmangiet më të larta deri në $+11^{\circ}\text{C}$ vrojtohen në pjesën veriore të hemisferës veriore. Anomalitë e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin europian paraqiten në vijim në figurën Nr.8 & Nr.10 dhe ato për vendin tonë në figurën Nr.9.




Figura Nr.7. – Anomalitë e temperaturave të ajrit (në $^{\circ}\text{C}$) për muajin dhjetor 2020 në shkallë globale dhe për kontinentin Europian.




Figura Nr.8. - Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin dhjetor 2020 për kontinentin Europian dhe anomalitë përkatëse ndaj periudhës shumëvjeçare 1981÷2010, sipas NOAA-s.




Figura Nr.9. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës (1961÷1990).
















Figura Nr.10. - Vlerat e anomalive të temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin European për disa javë të muajit dhjetor 2020, sipas NOAA-s.

Temperaturat maksimale të ajrit për muajin dhjetor 2020 shënuan një shmangie deri në rreth $+3.0^{\circ}\text{C}$ më të lartë se vlerat e normës për vendin tonë. Paraqitja grafike e vlerave mesatare të temperaturave maksimale për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë është dhënë në figurën Nr.13, ndërsa vlerat ekstreme maksimale në shkallë europiane jepen në figurën Nr.12.

Paraqitje grafike e ecursionit të temperaturave të ajrit dhe reshjeve (figurat Nr.11/1 ÷ 11/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të **Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik** për muajin dhjetor 2020.






Figura Nr.12. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për 5 javët e muajit dhjetor2020, sipas NOAA-s.




Figura Nr.13. – Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

Sa i takon vlerave të temperaturave maksimale absolute të ajrit të vrojtura gjatë muajit dhjetor 2020, për disa nga vendmatjet meteorologjike të SKMM të vendit tonë janë të paraqitur në figurën Nr.14.




Figura Nr.14. - Vlerat e temperaturës maksimale absolute të ajrit për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike.

Temperaturat mesatare minimale të ajrit në muajin dhjetor 2020 kaluan prapë e vlerave të normës duke patur një shmangie pozitive me +3.2°C. Në figurën Nr.15 janë paraqitur vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit, për muajin dhjetor 2020 në krahasim me ato të normës. Referuar figurës Nr.19 në të cilën paraqiten hartat e kontinentit European për vlerat e temperaturave minimale ekstreme, rajoni i Europës jugore ku bën pjesë dhe vendi ynë dallohet për vlera më të larta të temperaturave minimale.




Figura Nr.15. -Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

Gjithsesi duhet thënë se dhe në zonat më të thella malore, të cilat në këtë periudhë të vitit shënojnë vlera mjaft të ulta të temperaturave minimale, në fakt regjistruan vlera mjaft të moderuara.

Për ilustrim në figurën Nr.16 dhe Nr.17 paraqiten të dhënat e ecursë 24 orëshe të temperaturave të ajrit për vendmatjet meteorologjike të Thethit dhe Peshkopisë, ku vlerat minimale nën prapun zero gradë Celsius shënohen vetëm me një kohëzgjatje të shkurtër dhe në pak ditë.

Figura Nr.16. – Paraqitje grafike e ecursë së vlerave të temperaturës së ajrit për vendmatjen meteorologjike të Thethit për muajin dhjetor 2020.





Figura Nr.17. – Paraqitje grafike e ecursë së vlerave të temperaturës së ajrit për vendmatjen meteorologjike të Peshkopisë për muajin dhjetor 2020.

Në vijim vlerat e temperaturave minimale absolute për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë janë paraqitur në figurën Nr.18. Referuar vlerave të vendmatjeve të tjera, veçohet vendmatja e Zogajit në të cilën temperatura minimale absolute e regjistruar për muajin dhjetor 2020 është -13.6°C.




Figura Nr.18. - Vlerat e temperaturës minimale absolute të ajrit për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

Kjo situatë e vlerave të temperaturave minimale relativisht mjaft të larta kundrejt normës nuk përcolli ngrica në Ultësirën Perëndimore, ndërsa në pjesën tjetër të vendit ato ishin të moderuara, pak të ashpra dhe me kohëzgjatje të shkurtër.




Figura Nr.19. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për disa javë të muajit dhjetor 2020, sipas NOAA-s.

RESHJET ATMOSFERIKE

- Pas një muaji nëntor, pothuajse pa reshje në mbarë vendin (ose tepër të pakta aty ku u vrojtuan), ndonëse konsiderohet muaji më me reshje nga pikëpamja klimatike për vendin tonë, muaji dhjetor 2020 pasoi me një situatë pak më ndryshe duke përmirësuar gradualisht bilancin hidrik. Një vlerësim paraprak në shkallë kontinentale mbi reshjet edhe anomalitë e tyre është paraqitur në figurën Nr.20. Gjithsesi një analizë më e detajuar e reshjeve të muajit dhjetor jepet nëpërmjet të dhënave të përpunuara e paraqitura në vijim nëpërmjet grafikut të dhënë në figurën Nr.23 për lartësitë mujore të tyre, për disa nga vendmatjet e përzgjedhura si dhe në hartën e figurës Nr.26 ku pasqyrohet shpërndarja në hapësirë.




Figura Nr.20. - Reshjet për muajin dhjetor 2020 në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s.





Figura Nr.21. - Shpërndarja e reshjeve (në mm) në gadishullin e Ballkanit për muajin dhjetor 2020.

përqindje kundrejt normës. Nga sa paraqitet sa i takon Shqipërisë në pjesën veriore dhe perëndimore lartësitë e reshjeve janë dukshëm mbi normë, ndërsa në pjesën lindore të vendit tonë ato janë nën normë.

Figura Nr.22. - Reshjet për muajin dhjetor 2020 në kontinentin European të shprehura në përqindje kundrejt normës.






Figura Nr.23. - Vlerat e lartësisë së reshjeve për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe vlerat përkatëse të normave, referuar normës 1961÷1990.

Referuar vlerave të grafikut në figurën Nr.12, lartësia e reshjeve ka një shmanjie pozitive mesatarisht 112.7% në krahasim me normën në vendin tonë për muajin dhjetor 2020. Në vijim në figurën Nr. 24 paraqitet grafiku me treguesin e numrit të ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm.




Figura Nr.24. - Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat e normës 1961÷1990.




Figura Nr.25. - Reshjet maksimale 24 orëshe të vërtetuara për muajin dhjetor 2020 në Shqipëri.

Në figurën Nr.25 paraqitet grafiku me vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe për disa nga vendmatjet meteorologjike të SKMM, nga ku dallon vendmatja e Vrihthit me 252.5 mm. Në figurën Nr.28 paraqitet në mënyrë skematike shpërndarja gjeografike e reshjeve të datës 26 dhjetor si dita me më shumë reshje gjatë këtij muaji, nga ku veçohet zona fizikogjeografike e alpeve perëndimore me intensitetin më të lartë të reshjeve gjatë kësaj dite. Sa i takon numrit të ditëve me reshje mbi pragu 1.0mm në figurën Nr.27 paraqitet shpërndarja skematike për territorin e Shqipërisë. Gjithashtu edhe për këtë tregues siç duket në hartë veçohet pjesa veriperëndimore me numrin më të shumtë të ditëve me reshje. Në vijim, për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura të SKMM, në figurën Nr.29, paraqitet grafiku me treguesin e numrit të ditëve me reshje mbi pragu 10.0 mm.

19°0'0"E

20°0'0"E

21°0'0"E

UPT – IGJEUM

Departamenti i Klimës dhe Mjedisit

Figura Nr.26 - Shpërndarja
hapësinore e reshjeve për
muajin dhjetor 2020.

42°0'0"N

42°0'0"N

41°0'0"N

41°0'0"N

40°0'0"N

40°0'0"N

1 cm = 12 km



0 15 30 60 Kilometra

Source: Esri, Maxar, GeoEye,
Earthstar Geographics, CNES/Airbus
the GIS User Community

Legjenda

- Qytete
- Rrjeti lumor
- Liqene
- Kufiri shtetëror
- Izohietat

Reshje

Vlerat (në mm)

- 70+170
- 171+270
- 271+370
- 371+470
- mbi 470




Figura Nr.27 - Shpërndarja hapsinore e numrit të ditëve me reshje për muajin dhjetor 2020.

Figura Nr.28 - Lartësia e reshjeve në datën 26 dhjetor 2020 në territorin e Shqipërisë.






Figura Nr.29. - Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm për muajin dhjetor 2020 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat e normës 1961÷1990.



Figura Nr.30. – Pamje nga lugina e Vjosës si dhe atmosferës me vranësira të pjesëshme, kryesisht pranë zonave malore, më datë 11.12.2020. Foto nga maja e malit të Gramozit.



Java e fundit e muajit dhjetor 2020 nga data 23 deri më 29 evidenton një nivel më të lartë të reshjeve, të cilat të para dhe në shkallë kontinentale nxjerrin në pah hapësirën VP të vendit tonë, ku paraqiten vlerat më të larta të reshjeve, siç tregohet dhe në figurën Nr.32.

Figura Nr.32. – Paraqitje e situatës së reshjeve të vrojtuar në kontinentin European për periudhën 23÷29 dhjetor 2020.


Reshjet e dëborës gjatë muajit dhjetor 2020 ishin të pakta edhe në zonat e larta të vendit. Shkakun lidhet me faktin se masat ajrore më të ngrohta që

mbizotëruan gjatë këtij muaji edhe në rastin kur përcollën reshje ato u vrojtuan në formë shiu dhe shumë më pak në formë dëbore. Në vijim në figurën Nr.33. jepen pamjet satelitore të mbulimit të territorit të vendit tonë me dëborë për datat 1, 15 dhe 23 dhjetor 2020. Disa të dhëna për lartësinë e reshjeve të dëborës së vrojtuar në disa vendmatje meteorologjike janë si vijon: Kalimash 21 cm, Petkaj 7 cm dhe në Selishtë 14 cm.

Bilanci uhor i sipërfaqes së tokës i vlerësuar nëpërmjet simulimeve duke përdorur parashikimin numerik të motit (NWP) për datën 15 dhjetor 2020 paraqitet në figurën Nr.31. Ai është realizuar me një rezolucion 7 km dhe përgatitur nga ECMWF (Qendra Europiane e Parashikimit Afat Mesëm të Motit). Për normë krahasimi ka shërbyer periudha 30 vjeçare 1.1.1990 ÷ 31.12.2019. Bilanci uhor sipërfaqësor llogaritet dhe i referohet 60 ditëve më të fundit. Vlerat paraqiten në klasa me percentile në përputhje me modelet përkatëse në klimatologji.

Figura Nr.31. – Paraqitja e situatës së bilancit uhor sipërfaqësor të tokës më datë 15 dhjetor 2020.

{Klasat e përzgjedhura me percentile 5% dhe 33% të pjesës së lagët të shpërndarjes janë paraqitur në hartë dhe legjendë me vlerat -2 dhe -1, ndërsa vlerat midis 33% të pjesës më të thatë dhe asaj më të lagët janë shënuar si normale dhe paraqitur me vlerën 0}.






Figura Nr.33. – Pamje satelitore me mbulimin e territorit të Shqipërisë nga reshjet e dëborës për datat 1, 15 dhe 23 dhjetor 2020.

Të dhënat e reshjeve të parashikuara çdo ditë janë një informacion i rëndësishëm për të ri-analizuar situatën mbizotëruese me reshje për muajin dhjetor 2020, të cilat sipas produkteve të platformës SEEFFG, janë paraqitur në figurën Nr.34.




Figura Nr.34. – Vlerësimi i reshjeve të pritshme çdo ditë, për 24 orët në vijim sipas platformës “SEEFFG” për muajin dhjetor 2020.

Produktet e kësaj platforme janë një burim i rëndësishëm informacioni edhe në vlerësimin e situatave të përmbytjeve apo ngjarjeve të tjera ekstreme të motit, vlerësimin e shkrirjes së dëborës, etj. Gjithashtu ato shërbejnë dhe për ri-analiza dhe verifikime të mëvonshme të situatave të caktuara të motit apo dukurive të veçanta që kërkojnë vlerësime më të detajuara në kohë dhe në hapësirë.



Muaji dhjetor 2020 në zonën urbane përcolli temperatura më të larta se norma siç është vërtetuar edhe në muajt e mëparshëm. Për ilustrim në vijim paraqiten të dhënat e temperaturave të ajrit për Tiranën për muajin dhjetor sipas viteve (2012÷2020) ku për këtë dhjetor shënohet vlera 10.3°C ose +1.6°C më e lartë se mesatarja shumëvjeçare.




Figura Nr.35. - Të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin dhjetor për vitet 2012÷2020 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990 për Tiranën.

Ndërkohë, ajo çka konfirmohet dhe nga produktet e NOAA-s për Shqipërinë, zona J e JL e vendit u shoqëruan me anomali më të

larta. Në vijim paraqitja grafike në figurën Nr.36 e të dhënave të temperaturës së ajrit për Korçën evidenton një anomali prej +2.7°C kundrejt normës për muajin dhjetor 2020.






Figura Nr.36. - Ecuria e vlerave të temperaturës mesatare mujore të ajrit për vendmatjen meteorologjike të Korçës për muajt janar ÷ dhjetor 2020, vlerat e normës (1961÷1990) si dhe shmangiet përkatëse ndaj normës për vitin 2020 (në °C).





Në muajin dhjetor 2020 u shënuan vlera më të larta të temperaturave të ajrit në mbarë vendin tonë. Gjithsesi duhet thënë se këto ndryshime dhe anomali pozitive ishin të pranishme në mbarë kontinentin tonë, por me dy pamje; njëra ajo që i takon pjesës perëndimore me shmangie nën normë dhe ajo lindore me anomali mbi normë deri në $+9^{\circ}\text{C}$, kryesisht në pjesën V, L & JL të Europës.

Sa i takon vendit tonë duhet të ndalemi më specifikisht, ku referuar dhe informacioneve të tjera të dhëna më parë në buletinet e muajve të shkurtit është cituar fakti se Shqipëria përgjithësisht ndodhet në periferinë e ndikimit që paraqesin masat ajrore në rrugë kalimin e tyre në kontinent.



Kur ato arrijnë në hapësirat e vendit tonë përgjithësisht janë periferitë e tyre, të cilat natyrisht kanë karakteristika më të moderuara dhe jo aq të theksuara se sa në pjesët qendrore të tyre; si në rastin kur janë me origjinë nga pjesa veriore e kontinentit afrikan në periudhën e ngrohtë ashtu dhe në dimër kur mbizotërojnë ato me origjinë nga pjesët VP, L dhe VL të kontinentit. Tipike është dhe situata e paraqitur në javën e fundit të vitit 2020 e paraqitur në figurën Nr.37.

Figura Nr.37. – Anomalitë e temperaturave për periudhën 27 dhjetor 2020 deri 2 janar 2021.




Figura Nr.38. - Temperaturat ekstreme maksimale për periudhën 27 dhjetor 2020 deri 2 janar 2021 për kontinentin European dhe një pjesë të Ballkanit perëndimor.

Në shkallë kontinentale gjatë kësaj jave bie në sy vlerësimi i dhënë në figurën Nr.38 sipas NOAA-s, ku temperaturat ekstreme maksimale më të larta vrojtohen në hapësirën VL të vendit tonë dhe në Kosovë me mbi $+5^{\circ}\text{C}$ duke shënuar vlera edhe mbi 25°C . Kjo situatë kërkon një analizë më të thelluar dhe verifikime të informacionit të marrë nga të gjitha vendmatjet

meteorologjike si brenda vendit ashtu dhe jashtë për të nxjerrë arsyet dhe faktorët e kësaj anomalie dhe përputhshmërinë me informacionet satelitore.

Ndonëse Shqipëria është një vend i vogël nga sipërfaqja, kushtet fiziko gjeografike dhe pozicioni i vendndodhjes në kontinent bëjnë të mundur një variabilitet mjaft të lartë të karakteristikave meteorologjike, të cilat nga pikëpamja klimatike e ndajnë vendin në 4 zona dhe 13 nën nënzona klimatike. Largësia nga deti apo lartësia mbi nivelin e detit i kushtëzojnë ndryshime të rëndësishme në vlera masave ajrore kur kalojnë mbi hapësirën e vendit tonë (shih

dhe figurën Nr.39). Në këtë kontekst shpesh herë situata në vendin tonë paraqet karakteristika klimatike, të cilat vëroqtohen në të njëjtën kohë dhe në vende të tjera duke filluar nga vendet nordike e deri tek ato më në jug si gjerësi gjeografike si jugu i Spanjës apo pjesët më jugore të Greqisë. Për një ilustrim të këtyre situatave për muajin dhjetor 2020 në figurën Nr.39 paraqiten të dhënat e datave 3 dhe 20 dhjetor 2020 ku në vendin tonë dallohen 4 zona, të cilat në fakt vëroqtohen në pjesën më të madhe të hapësirave të kontinentit Europian.




Figura Nr.39. - Temperaturat ekstreme minimale dhe maksimale më datë 3 dhe 20 dhjetor 2020 për kontinentin Europian dhe hapësirën e vendit tonë sipas NOAA-s.



Figura Nr.40 - Pamje e situatës së atmosferës në datë 9 dhjetor 2020 nga Llogaraja, Vlorë - Shqipëri (foto: A. Hasimi).



Klima dhe Bujqësia – Muaji dhjetor shënoi fundin e periudhës së vegjetacionit në një pjesë të mirë të territorit; pas një tejzgjatje të veçantë të saj gjatë këtij viti. “Rrëshqitja” e stinëve dhe muajve mundësoi një muaj dhjetor më pranë një muaji vjeshte për sa i përket disa karakteristikave klimatike, si për temperaturat ashtu dhe për reshjet. Periudha e vegjetacionit evidentoi për vitin 2020 si për mbarë vendin një tejzgjatje të saj. Për Tiranën me rreth plus 47 ditë, duke kaluar nga një fillim më datën 13 mars sipas normës në 11 shkurt për 2020 dhe mbarim nga data 24 nëntor sipas normës në datën 10 dhjetor për 2020. Paraqitje grafike jepet në vijim në figurën Nr.41. Temperatura mesatare e periudhës së vegjetacionit për vitin 2020 ishte 19.0°C. Gjatë vitit 2020 u shënuan vetëm 8 ditë me ngrica. Gjatë këtij viti ngricat nuk u bënë faktor për ndërprerjen e periudhës së vegjetacionit si në pranverë ashtu dhe në vjeshtë.






Figura Nr. 41 . – Pamje skematike e periudhës së vegjetacionit për Tiranën referuar vlerave të normës dhe atyre të vitit 2020.

Treguesi NDVI i dhënë sipas informacioneve satelitore të NOAA-s për vendin tonë në figurat në vijim Nr.42 pasqyron qartë situatën e vegjetacionit në territor, ku edhe për muajin dhjetor 2020 duket se përmbyllja e kësaj periudhe sapo është shënuar në zonën e lartë të vendit dhe më pas gradualisht javë pas jave ka filluar të zbresë dhe në zonat më të ulta.



NDVI



(This 7-day composite maps over Albania at 4-km spatial resolution are produced at NOAA/NESDIS, and derived from the NASA's VIIRS satellite measurements. Source: NOAA/NESDIS, courtesy of Dr. Cezar Kongoli).








Figura Nr.42. – Paraqitja për data 1, 8, 15, 22 dhe 29 dhjetor 2020 e situatave të treguesit NDVI sipas NOAA-s për Shqipërinë.



Dikur në vitet 1960, '70 ose '80, limonat apo agrumet në tërësi ishin të pamundura të rriteshin e zhvilloheshin normalisht dhe të plotësonin ciklin e tyre në zonën e Tiranës, pikërisht për shkak se kërkesat e tyre biologjike për një tregues ngrohtësie të llogaritur nëpërmjet $\Sigma TA > 10^{\circ}\text{C}$ ishin larg nevojave jetike të tyre. Situata në vitet e fundit ka ndryshuar dukshëm. Në vijim bëhet një analizë e detajuar e disa treguesve ku shifrat evidentojnë qartë këto ndryshime, të cilat duhen parë me kujdes nga specialistët e bujqësisë, fermerët dhe konsideruar në vendim-marrjet për



prioritetet strategjike të zhvillimit si në bujqësi ashtu dhe në blegtori. Analiza i referohet dy zonave, asaj të pjesës qendrore të UP të vendit si dhe asaj JL të fushës së Korçës.

*Figura Nr. 43 . –
Pamje e nga gjendja
mjaft mirë e rritjes
së limonëve në
Tiranë, më datë 27
dhjetor 2020 (foto:
P. Zorba).*

Gjatë vitit 2020 reshjet shënuan vlerën prej 1038.2mm ndërsa për periudhën e vegjetacionit lartësia e tyre ishte 862.3mm. Sa i takon burimeve agroklmatike të ngrohtësisë për Tiranën për periudhën e vegjetacionit u vrojtua një shumë temperaturash aktive mbi prapun 10°C prej 5635.1°C , vlerë rreth +20% kundrejt atyre të normës prej 4856.0°C . Treguesi i $\Sigma TE > 10^{\circ}\text{C}$ për vitin 2020 për Tiranën arriti në vlerën 2766.1°C . Një paraqitje më e detajuar grafike jepet në figurën Nr.44 për vlerat ditore të reshjeve dhe temperaturave minimale e maksimale të ajrit për vendmatjen meteorologjike të Tiranës. Ndërkohë një analizë mujore e reshjeve dhe lartësisë së tyre sipas muajve dhe anomalive përkatëse kundrejt normës të dhëna në % janë paraqitur në figurën Nr.45. Sa i takon treguesit më të rëndësishëm të burimeve agroklmatike të ngrohtësisë ai i $\Sigma TA > 10^{\circ}\text{C}$ paraqitur në figurën Nr.46 evidentohej dukshëm një rritje e theksuar kundrejt normës, por me anomalitë më të larta të vrojtuar në periudhën e ftohtë të vitit.




Figura Nr.44. – Ecuria e temperaturave minimale, mesatare, maksimale si dhe reshjeve për Tiranën për vitin 2020.




Figura Nr.45. – Ecuria e reshjeve për Tiranën për vitin 2020, vlerat e normës si dhe ndryshueshmëria në %.





Figura Nr.46. – Ecuria e vlerave progresive të $\Sigma TA > 10^\circ C$ për Tiranën për vitin 2020, vlerat e normës si dhe ndryshueshmëria në %.

Në tërësi e gjithë Ultësira Perëndimore gjatë muajit dhjetor shënoi fundin e periudhës së vegjetacionit. Për ilustrim në vijim në figurën Nr.47 paraqitet ecuria e temperaturave për vendmatjen meteorologjike të Urës së Shtrenjtë në pjesën veriore të Ultësirës, ku siç shihet edhe në këtë zonë për këtë muaj mungojnë ngricat. Ngricat konsiderohen një faktor i rëndësishëm për ndërprerjen para kohe të periudhës së vegjetacionit.

Figura Nr.47. – Paraqitje grafike e ecurisë së vlerave të temperaturës së ajrit për vendmatjen meteorologjike të Urës së Shtrenjtë për muajin dhjetor 2020.



Kohëzgjatja më e madhe e periudhës së vegetacionit si dhe një tregues i $\Sigma TA > 10^{\circ}\text{C}$ më i lartë se norma me rreth +20% evidentohet dhe në vendmatjet e tjera për zonat dhe nënzonat e tjera klimatike të vendit. Në vijim situata ilustron me të dhënat e Korçës, përfaqësuese e një hapësire të rëndësishme bujqësore në zonën JL të vendit.





Figura Nr.48. – Ecuria e temperaturave minimale, mesatare, maksimale si dhe reshjeve për Korçën për vitin 2020.

Për Korçën gjatë vitit 2020 periudha e vegetacionit u vrojtua nga data 9 prill deri më 11 nëntor me një kohëzgjatje prej 216 ditësh. Gjatë vitit temperatura mesatare e ajrit arriti në 12.8°C, vlerë që ishte +2.5°C më e lartë se norma. Ndërsa periudha e vegetacionit u shoqërua me një temperaturë mesatare të ajrit prej 18.0°C. Ngricat nuk u bënë pengesë për ndërprerjen e periudhës së vegetacionit para kohe si në fillim ashtu dhe në fund të saj. Periudha pa ngrica u vrojtua nga data 3 prill deri më datë 21 nëntor. Në tërësi gjatë këtij viti u shënuan vetëm 55 ditë me ngrica, më pak se vlera mesatare prej 87 ditësh e vrojtuar në periudhën e më parëshme 2002÷2019. Gjatë vitit 2020 u vrojtua një sasi totale e reshjeve prej 840.6 mm, ndërsa për periudhën e vegetacionit 505.0mm. Lartësia vjetore e reshjeve të vitit 2020 kundrejt vlerës së normës është në raport 108.1%. Sa i takon burimeve agroklimatike të ngrohtësisë për periudhën e vegetacionit u vrojtua një shumë temperaturash aktive mbi pragu 10°C prej 3792.1°C dhe një shumë temperaturash efektive prej 1732.1°C.

Figura Nr.49. – Ndryshimi ndër vite i treguesit të $\Sigma TA > 10^{\circ}\text{C}$ për Korçën.

Shpërndarja pak a shumë uniforme e reshjeve në zonën e Korçës gjatë vitit 2020 dhe sidomos prania e tyre në periudhën e verës

që shquhet për mungesë të tyre, krijoi këtë vit një situatë mjaft pozitive në plotësimin e nevojave të kulturave bujqësore dhe drufrutorëve për lagështi, e cila u reflektua dhe në prodhime më të larta sipas burimeve paraprake të informacionit nga fermerët e zonës dhe institucionet rajonale të bujqësisë. Figura Nr.49 pasqyron mjaft qartë këtë situatë të veçantë të këtij viti për bilancin hidrik dhe një deficit mjaft të vogël të kufizuar në kohë për muajt gusht - shtator.






Figura Nr.50. – Ecuria e reshjeve për Korçën për vitin 2020, vlerat e normës si dhe ndryshueshmëria në %.




Figura Nr.51. – Ecuria e lartësisë së reshjeve sipas periudhave dhjetëditore si dhe vlerat e përlllogaritura për avullimin potencial për Korçën për vitin 2020.

Për një informacion më të gjërë në shkallë kontinentale në figurën në vijim Nr.52 paraqiten vlerat e avullimit të llogaritur për muajin dhjetor 2020, të cilat falë temperaturave më të larta shënuan një rritje të lehtë relative si dhe vlerat e anomalive të lagështisë së tokës në figurën Nr.53.






Figura Nr.53. – Paraqitja vlerave të treguesit të anomalive të lagështisë së tokës (në mm) për muajin dhjetor 2020 në shkallë kontinentale.

Figura Nr.52. – Paraqitja vlerave të treguesit të avullimit të llogaritur (në mm) për muajin dhjetor 2020 në shkallë kontinentale.





Një nga burimet e energjive të rinovueshme lidhet me potencialin që ofron klima e vendit tonë përse i takon rrezatimit diellor. Përdorimi i sistemeve me panele diellore, mundëson konvertimin e rrezatimit diellor në energji elektrike ose termike. Në këtë kontekst është evidentuar herë pas here në këtë buletin se sa i pasur është vendi ynë nga pikëpamja klimatike në lidhje me këtë tregues. Në vijim në hartën e paraqitur në figurën Nr.x. paraqiten të dhënat e rrezatimit diellor sipërfaqësor në $W/m^2/m$ për muajin dhjetor, kur në fakt shënohet dhe niveli më i ulët i këtij treguesi ndër gjithë muajt e vitit.





Moti ekstrem. - Gjatë muajit dhjetor 2020 u vërtetua 1 stuhie e kategorisë së parë, 2 të kategorisë së dytë dhe asnjë e kategorisë së tretë. Stuhitë u vërtetuan në Mesdhe dhe u shoqëruan me erë të fortë, reshje, breshër dhe shkarkesa elektrike. Për ilustrim në figurën Nr. 55 paraqitet një ndër situatat e parashikimit të stuhive në shkallë kontinentale vlerësuar më datë 08 dhjetor 2020 (ESTOFEX), e cila pjesërisht preku dhe vendin tonë.






Figura Nr.55. – Situata e parashikimit të stuhive në datë 08 dhjetor 2020 ora 21:16 UTC për kontinentin European e vlefshme për dy ditët në vijim nga data 09.12.2020 ora 06:00 deri datë 10.12.2020 ora 06:00 UTC.

Në figurën Nr. 56 paraqitet situata 48 orëshe e rrufeve e datave 08÷10.12.2020 me një numër total prej 27.657 goditjesh, ndërsa në figurën Nr.57 paraqitet situata për muajin dhjetor 2020 me një numër total të rrufeve prej 326.628 goditjesh në shkallë kontinentale.



Figurën Nr.56. Situata e rrufeve nga data 08.12.2020 ora 00:00 UTC deri në datën 10.12.2020 ora 06:00 UTC.



Figurën Nr.57. Numri total i rrufeve në kontinentin European gjatë muajit dhjetor 2020.



VLERËSIMI MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM

Në figurat në vijim Nr.58÷Nr.59 paraqiten vlerësimet afatmesme dhe afatgjata mbi situatën meteorologjike të pritshme për muajt në vijim mbi hapësirën e kontinentit Europian dhe të Mesdheut.

Siç modelet matematikore meteorologjike evidentojnë, për periudhën Janar ÷ Prill 2021, përkatësisht për çdo muajt, mund të vlerësohet se muajt e dimrit kanë trend temperaturash pak mbi mesataret shumëvjeçare.

Kjo situatë paraqitet në të gjithë kontinentit Europian. Ndjeshëm mbi mesataren shumëvjeçare parashikohen muajt e dimrit për Europën Qëndrore dhe atë Juglindore, kurse për Europën Veriore situata parashikohet brenda normave, ndoshta me trend ulje temperaturash krahasuar me mesataren shumëvjeçare. Ky trend pritet të shoqërohet me anomali përsa i përket rreshjeve, të cilat kanë trend në rënie, por me dukuri ekstreme në zonat Qëndrore dhe Juglindore të Europës.

Nga parashikimi afatmesëm në hapësirat e Mesdheut, për muajt e dimrit parashikohen reshje mbi normën krahasuar me vlerat mesatare shumëvjeçare. Gjithashtu parashikohen anomali të theksuara dhe fenomene ekstreme në zonën e detit Adriatik dhe Jon, përsa i përket reshjeve.


